Kronikë

Kurbin/ Me motor pa targa dhe i armatosur po shkonte të vriste kushëririn e tij, arrestohet 53-vjeçari (EMRI+VIDEO)

Një vrasje me kushërinjsh është parandaluar në Lezhë. Luan Farruku, 53-vjeç ka tentuar të vrasë kushëririn e tij M.F, 50-vjeç pas një konflikti mes tyre, por është arrestuar nga policia

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
18 Gusht, 10:40 | **Përditësimi: 18 Gusht, 11:00**

Share

LEZHË- Një vrasje me kushërinjsh është parandaluar në Lezhë. Luan Farruku, 53-vjeç ka tentuar të vrasë kushëririn e tij M.F, 50-vjeç pas një konflikti mes tyre, por është arrestuar nga policia.

Ka qenë kushëriri i tij, i cili ka lajmëruar blutë e Lezhës, pasi ishte kanosur për jetën me armë zjarri dhe kishte frikë se mos i afërmi i tij do t'i shkonte për ta vrarë në banesë.

Pas kallëzimit të 50-vjeçarit, policia ka kryer kontrolle në terren dhe ka arrestuar autorin e dyshuar Luan Farruku, i cili ishte i armatosur në rrugën e fshatit që të çon pran banesës së kushëririt të tij.

LEXO EDHE:
Pasuroi kulturën shqipe! Del në dritë vepra letrare e klerikut Don Jak Zekaj

'Shërbimet e Policisë ndërhynë me profesionalizëm duke neutralizuar dhe arrestuar në flagrancë 53-vjeçarin, i cili po lëvizte me një motomjet pa targa, i armatosur me një pistoletë me fishek dhe një thikë, duke kërkuar kushëririn e tij, 50-vjeçarin M. F., me qëllimin për ta vrarë.'- njofton policia.

53-vjeçarit iu sekuestrua një pistoletë, një thikë, motomjeti pa targa dhe municionet që posedonte Luan Farruku.

Njoftimi i plotë i policisë

'Policia parandalon vrasjen e mundshme, arrestohet 53-vjeçari që kërkonte të vriste kushëririn e tij.

Finalizohet operacioni policor i koduar "Cousin," nga Komisariati i Policisë Kurbin në bashkëpunim me Forcat Kombëtare të Sigurisë, Njësia Shkodër.

53-vjeçari qarkullonte me motomjet pa targa, i armatosur me pistoletë dhe municion luftarak, në kërkim të kushëririt të tij, të cilin e kishte kërcënuar për vrasje, ndërhyrja në kohë e Policisë parandaloi ngjarjen e rëndë dhe vuri në pranga autorin.

Gjatë operacionit, u sekuestruan një pistoletë, një thikë, motomjeti pa targa dhe municionet që posedonte 53-vjeçari.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Kurbin, menjëherë pas kallëzimit të administruar nga shtetasi M. F., 50 vjeç, banues në fshatin Gjormë, Kurbin, se për shkak të një konflikti shëririi i tij, shtetasi L. F., 53 vjeç, e kishte kanosur për jetën me armë zjarri dhe për këtë fakt kishte frikë të shkonte në banesë, organizuan menjëherë punën për parandalimin e ngjarjes, kapjen dhe vënien në pranga të autorit.

Falë veprimeve të shpejta profesionale, bazuar në inteligjencën policore dhe kontrollin e territorit në kuadër të operacionit "Cousin", shërbimet e Komisariatit të Policisë Kurbin në bashkëpunim me Forcat Kombëtare të Sigurisë, Njësia Shkodër, bënë të mundur lokalizimin e autorit të dyshuar, shtetasin L. M., 53 vjeç, në rrugën e fshatit pranë banesës së shtetasit M. F.

Shërbimet e Policisë ndërhynë me profesionalizëm duke neutralizuar dhe arrestuar në flagrancë 53-vjeçarin, i cili po lëvizte me një motomjet pa targa, i armatosur me një pistoletë me fishek dhe një thikë, duke kërkuar kushëririn e tij, 50-vjeçarin M. F., me qëllimin për ta vrarë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të tfohta" dhe "Kanosja."- njofton policia.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: tentative vrasje | Lezhë | luan farruku

Komento

Komente

Kola: 18/08/2024 11:17

Për prokurorët dotë dali pistolet lodër dhe shpejt dotë lirohet për një shërbim financiar.

Përgjigju

© Ndalohet reprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Ftesa e Ramës, a duhet të kthehen emigrantët që punojnë në turizëm?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Lezhë/ Kapet në mes të pyllit duke kultivuar kanabis, asgjësohen 250 bimë! Arrestohet 43-vjeçari
17 Gusht, 10:54

"Shtegtarët" shqiptarë, emocione në qytetin e lindjes! Festë mirënjohjeje në Lezhë
Elvis Hila
16 Gusht, 13:03

Pamjet/ Droni e kap 'mat' teksa kujdesej për plantacioninë e kanabisit në pyjet e Kaçinarit, arrestohet! Ikën bashkëpunëtori, nën akuzë kryeplaku e 2 specialistë
16 Gusht, 11:17

Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, mjeti përplaset me barrierat metalike! Shoferi në spital
16 Gusht, 07:43

Marrëveshja me Italinë për emigrantët, UNHCR do të monitorojë kampet në Shëngjin
15 Gusht, 17:25



Gjergj Luca i dedikon restorantin e ri Giorgia Melonit: Ka ndihmuar 500 mijë shqiptarë të marrin pensionin
15 Gusht, 13:19

Vrau shokun e dhomës me bastun në azil, 78-vjeçari Zyhdi Shehi nuk shtrohet në psikiatri, dërgohet në burgun e Lezhës
13 Gusht, 13:33

EMRI/ Mjeti i tonazhit të rëndë me të cilin punonte del nga rruga, vdes shoferi në Rubik
12 Gusht, 10:58

Atentat në Fushë-Krujë? Qëllohet me armë drejt një makinëse se një të huaje, në mjet edhe një tjetër! Asnjë gjurmë nga autorët
11 Gusht, 09:58

Shëngjini, destinacioni i preferuar i shqiptarëve të Kosovës! Gushti shënon rritje krahasuar me korrikun
Elvis Hila
10 Gusht, 18:47

Rrahën me shufra hekuri 28-vjeçarin dhe e lanë të gjakosur në rrugë, 4 të arrestuar në Itali, mes tyre dhe një shqiptar
10 Gusht, 15:56

Vdes në spital i dënuari për abuzim me të mitura! Në burg prej vitit 2001, nuk kishte kontakte me familjen (Emri)
10 Gusht, 15:43

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje